



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:150777
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05873288

CAP.nr.551/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren individuale Nora Bllaca Dula, në çështjen përmbaremore të kreditorit KS ‘S.....’ Sh.a me seli në P....., ndaj debitorit H.M nga fshati D....., Komuna e D....., me bazë juridike rimbursim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, 2022:150777, të datës 20.02.2024, me datë 25.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit H.M nga fshati D....., Komuna e D....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, 2022:150777, të datës 20.02.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar 2022:150777, të datës 20.02.2024, ka vendosur si në vijim: “*I.REFUZOHET SII PABAZUAR prapësimi i ushtruar nga Haxhi Sh.M nga fshati D....., K-D..... ndaj kreditorit KS “S.....” me seli në P....., i paraqitur kundër urdhrit për përmbaremore të përmbareuesit privat P.nr.42/2022 të dt. 28.06.2022.*

II. Mbetet ne fuqi urdhri i përmbareuesit privat M.M P..... P.nr. 42/2022 të dt. 28.06.2022.

III. Obligohet-debitori ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaremore”.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe vërtetimit të mangët dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me

propozim drejtuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa e debitorit si e bazuar, dhe të hedhet poshtë aktvendimi i goditur dhe urdhri të lihet jashtë fuqie me arsyet si në propozim të ankesës.

Ankesa e debitorit i është dorëzuar kreditorit për përgjigje, por i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit me datën 28.06.2022, ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbartimor Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, 2019:144706, të datës 28.02.2022 i plotfuqishëm nga data 25.03.2022, i ekzekutueshëm i datës 18.04.2022, baza juridike për rimbursimin e dëmit.

Përmbartuesi Privat M.M, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.42/2022 të datës 28.06.2022, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga ana e kreditorit.

Debitori në afat ligjor ka ushtruar prapësim duke kërkuar që prapësimi i ushtruar nga debitori të pranohet si i bazuar dhe urdhri i përmbartuesit privat të ndryshohet. P.nr.69/2022 të dt.28.06.2022, me arsyetim se është bërë shkelje dispozitive ligjore dhe procedurale, vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike si dhe cenimit të drejtës materiale. Dhe të aprovohet prapësimi dhe të hudhet poshtë si pa lejuar propozimi për përmbartim i kreditorit.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim dhe ka kërkuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar në kuptim të nenit 71 sipas dispozitës ligjore shprehimisht janë numëruar shkaqet mbi bazën e të cilës mundet të parashtrohet prapësimi bazuar në nenin 69 të këtij ligji dhe në bazë të nenit 35 të LPP nuk ekzistojnë asnjë kushte ligjore për ndërprerjen e procedurës përmbartimore në këtë çështje përmbartimore. Prapësimi është ushtruar nga debitorë me qëllim të zvarritjes së procedurës dhe ka kërkuar që të refuzohet prapësimi si pabazuar.

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Deçan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë aktvendimin 2022:150777, të datës 20.02.2024, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se pas vlerësimit të prapësimin të debitorit gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për arsye se pretendimet nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbartimin e lejuar, duke shtuar se dokumenti mbi të cilin është mbështetur urdhri mbi lejimin e përmbartimit ka titull ekzekutiv dhe se nuk përmban asnjë nga shkaqet e parapara nga neni 71 par 1 nën par 1.1 – 1.12 të LPP –së, po ashtu debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova siç parashihet në nenin 69 par 4 të LPP –së, prandaj në rastin konkret gjykata e shkallës së

parë ka vlerësuar se dokumenti përmbarimor në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, 2019:144706, të datës 28.02.2022 i plotfuqishëm nga data 25.03.2022, i ekzekutueshëm i datës 18.04.2022, përmban shumën e detyrimit, në të tregohet kreditori dhe debitori, si dhe ka kaluar koha e përmbushjes vullnetare (afati paritiv) i cili i është lënë debitorit në bazë të këtij vendimi. Gjykata vlerëson se në rastin konkret aktgjykimi i lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafi 1 të LPP-së, ngase është dorëzuar në origjinal dhe përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë. Së këndejmi gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se ky dokument është i përshtatshëm për përmbarim. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, ka vlerësuar se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit të parë lidhur me atë se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përmbarues në bazë të cilit është lejuar përmbarimi është aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, 2019:144706, të datës 28.02.2022 i plotfuqishëm nga data 25.03.2022, i ekzekutueshëm i datës 18.04.2022, i cili në rastin konkret është dokument përmbarues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: *“dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje dhe interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Pretendimet e debitorit për shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përmbarimore gjykata me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke ju përmbajtur parimit të rigorozitetit formal-juridik që nënkupton se

gjykata do të vlerësoj shkaqet për prapësim por nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera, pasi që këto pretendime kanë mundur të paraqiten në kohën kur është marrë dokumenti përmbarues.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përmbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarës individuale në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së (i cili është në fuqi aktualisht, me numër 04 L-139), me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.551/2024, me datë 25.06.2024

Gjyqtarja
Nora Bllaca Dula, d.v